



Sqarime rreth "Kërkesës për amandamentimin e Kodit të Pajisjeve Elektrike"

KOSTT bazuar në aktivitetet e veta në projektet e reja ka bërë kërkesë te KQKO për amandamentimin e Kodit të Pajisjeve Elektrike.

KQKO ne takimin e rregullt të mbajtur me 3 shkurt 2009 ka shqyrtuar raportin e përgatitur nga grupi punues "Vlerësimi i ndërrimit të parametrave në nenin 3.2 të Kodit të Pajisjeve Elektrike". Meqenëse takimi nuk ishte organizuar në nivelin e duhur dhe nuk ishte prezent asnjë anëtar i grupit punues për të sqaruar kërkesën e cila dukej e mangët, u vendos që të kërkohet nga KOSTT të organizojë një punëtori në të cilën do të sqaroheshin paqartësitë që ekzistonin.

Me datën 10 shkurt KOSTT ka organizuar punëtorinë në të cilën janë dhënë sqarime shtesë me argumente për nevojën e amandamentimin të Kodit të Pajisjeve Elektrike, nenin 3.2, por dhe me kërkesë të re për amandamentimin e Nenit 17.4.2.2 po ashtu në Kodin e Pajisjeve Elektrike. Edhe për këtë nen janë dhënë sqarime të nevojshme.

KQKO ne takimin e jashtëzakonshëm të mbajtur me 11 shkurt 2009 ka shqyrtuar edhe një herë kërkesën sipas raportit të përgatitur nga grupi punues "Vlerësimi i ndërrimit të parametrave në nenin 3.2 të Kodit të Pajisjeve Elektrike" dhe kërkesën e re të neni 17.4.2.2 të te njëjtit dokument.

Në nenin 3.2 të Kodit të Pajisjeve Elektrike thuhet:

3.2 Normal Current Ratings of Equipment

3.2.1.1 Unless otherwise stated, the normal current ratings of all equipment to be connected to the TSMO network shall be:

Nominal Sysyem Voltage (kV)	Maximum Normal Current (A)	Short Circuit Current (kA)	Fault Duration (S)
400	2500	40	3
220	3150	40	3
110	3150	40	3
10	2500	[31.5]	3
6.3	2500	[31.5]	3

Në shqip do të ishte:

3.2 Rrymat nominale të pajisjeve

3.2.1.1. Nëse nuk vendoset ndryshe, rrymat nominale e të gjitha pajisjeve të cilat kyçën në rrjetin e OST duhet të jenë:

Tensioni nominal (kV)	Rryma maksimale nominale (A)	Rryma e lidhjes së shkurtë (kA)	Kohëzgjatja e prishjes (s)
400	2500	40	3
220	3150	40	3
110	3150	40	3
10	2500	[31.5]	3
6.3	2500	[31.5]	3

Ndërsa KOSTT përmes KQKO kërkon të definojen si më poshtë:

Tensioni nominal (kV)	Rryma nominale (A)	Rryma e lidhjes së shkurtë (kA)	Kohëzgjatja e prishjes (s)
400	2500*	40	1
220	2500	40	1
110	2500	40	1**
10	3150	40	1
6.3	3150	40	1

* Ne raste specifike dhe kondita te veçanta te verifikuara nga analizat e kryera nga OST, rryma prej 3150A mund te aplikohet. (Rasti i fushës lidhëse në nënstacionin “Kosova e re”).

** për çdo projekt veç e veç të analizohet nevoja e vendosjes eventuale në **3s**.

Shënim: Niveli i tensioneve 10 kV dhe 6.3 kV i referohen shpenzimeve vetanake të Nënstacioneve 220/110 kV, respektivisht terciarit të autotransformatorëve 220/110 kV



Nga KOSTT është kërkuar që për këtë të sjellë analiza përkatëse dhe si rezultat i kësaj materialit i janë bashkangjitur skemat njëpolshe të disa nënstacioneve më karakteristike dhe ai i nënstacionit të parashikuar të Kosovës së Re. Po ashtu janë edhe pjesë të nxjerra nga IEC kodi, pikërisht neni 60694 dhe 62271-100. Në të dy këto nene përshkruhet se përveç vlerës **1s** janë të rekomandueshme edhe vlerat **0.5s**, **2s** dhe **3s**

Edhe në nenin 17.4.2.2 për të cilin KOSTT po ashtu kërkon të ndërrohen disa vlera me arsyetimin se vlerat e vjetra janë të tejkaluara duke pasur parasysh zhvillimet e shpejta në teknologjinë elektronike. Ky nen është:

17.4.2.2 Optical fibre ground wire (OPGW) shall be installed on all extensions or upgrading to the network of the TSMO where the circuits being extended or upgraded already have OPGW installed; where the circuits being extended or upgraded are identified on the plan approved by the ERO as circuits that will form part of the TSMO's proposed fibre optic telecommunications network; or where the extension being undertaken requires the provision of telecommunications circuits (for example to facilitate the installation of protection systems requiring the provision of secure end to end telecommunications circuits). The number of fibres shall be no less than 48 with an operational wavelength of 1300nm and transmission speed of 565Mb/s. Where OPGW is used, the metallic component shall be equivalent to 126.1 mm² ACSR earthwire.

Kërkohet të modifikohet në:

17.4.2.2 Optical fibre ground wire (OPGW) shall be installed on all extensions or upgrading to the network of the TSMO where the circuits being extended or upgraded already have OPGW installed; where the circuits being extended or upgraded are identified on the plan approved by the ERO as circuits that will form part of the TSMO's proposed fibre optic telecommunications network; or where the extension being undertaken requires the provision of telecommunications circuits (for example to facilitate the installation of protection systems requiring the provision of secure end to end telecommunications circuits). The number of fibres shall be no less than 48 fibres of the type described in ITU-T G.655 recommendation with an operational wavelength of 1550nm and **transmission** speed of 622Mb/s. Where OPGW is used, the metallic component shall be equivalent to 126.1 mm² ACSR earthwire.

Për këtë pike është bërë gjithashtu një prezantim për të arsyetuar ndryshimet. Aty janë paraqitur rrjedhat e ndryshimeve të kapacitetit transmetues të fibrave optike prej vitit 1980 e deri në periudhën pas të 2000 nga 2 MB/S në 10 GB/s e në pritje 40 GB/s.